



UNMIK



INSTITUCIONET E PËRKOSSHME VETËQEVERISËSE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E  
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE  
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Office of Minister

Kabineti i Ministrit

## UDHËZIM ADMINISTRATIV

**Masat ndaj prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë regjistruar apo nuk vijnë në mësimin e obliguar .**

**NUMËR : MASHT [I] 13/2005**

**DATË: 23.03.2005**

Në bazë të nenit 1.3 pika ç) të Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/19 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë , nenit 7, paragrafi 7.14 dhe 7.15, të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), nxjerr këtë Udhëzim Administrativ :

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim të përcaktoj masat ndëshkuese, që do të merren ndaj atyre prindërve , fëmijët e të cilëve për arsye të ndryshme nuk i regjistrojnë apo e ndërprejnë shkollimin e detyruar .

### **Neni 2**

#### **Mosvijimi i mësimin**

**2.1.** Është shkelje ligjore për një prind , fëmija i të cilit ka mbushur moshën e caktuar për vijimin e mësimin të detyruar, dhe nuk është i regjistruar në shkollë apo nuk vijon mësimet .

**2.2.** Mësimin e detyruar duhët ta ndjekin të gjithë fëmijët e moshës së caktuar me ligj , qoftë në shkollë publike komunale apo shkollë private e licencuar nga MASHT-i .

**2.3** .Shkollimi i detyruar fillon nga mosha 6 (gjashtë) vjeqare dhe përfundon në moshën 15 (pesëmbëdhjetë) vjeqare.

### **Neni 3**

#### **Masat ndëshkuese**

**3.1.** Në qoftë se një nxënës nuk është i regjistruar apo mungon në procesin e arsimit të detyruar, prindi i tij (saj) detyrohet të paguaj gjobë, po që se mungesa apo mosvijimi vjen si rezultat i veprimeve të qëllimshme apo nga neglizhenca e prindit .

**3.2.** Drejtorati Komunal i Arsimit vendos për ngritjen e padisë kundërvajtëse ndaj prindit.

**3.3.** Në rast të padisë ndaj prindit, Drejtorati Komunal është i obliguar ta njoftoj me shkrim MASHT-in .

**3.4.** Masat (ndëshkimet) për prindin përcaktohen në përputhje me ligjin përkatës për vepra kundërvajtëse .

### **Neni 4**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Ministri .

---

**Agim Veliu , Ministër**